

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: "REHABILITIMI I SKEMES UJITSESE TE FUSHES SE BULOS
SI DHE KANALIT KKULLUES K-1-76 FUSHE NEPRAVISHTE" -
BASHKIA LIBOHOVË

I.- HYRJA

Zona ku shtrihen Kanalet Ujitjës te Fushes se Bulos, nga pikepamja gjeografike shtrihen në krahun e djathte të luginës së lumit te Suhes, duke filluar nga vepra e marrjes që ndodhet mbi fshatin Bulo (Rezervuari i Doftise) dhe vazhdon deri ne kufi me bashkine Dropull dhe Gjirokaster dhe vazhdon ne fund te shpatit te kodres. (Shih hartën e zonës në Sh. 1 : 25 000)

Kryesisht tokat e ujitshme të këtij sistemi, shtrihen, në një zonë fushore me lartësi që lëviz nga 225 deri ne 215 m m.n.d.. Masivi i tokave që do të ujiten nga ky kanal, përgjithësisht është i sistemuar mire. Si burim furnizimi me uje sherben kanali kryesor i furnizimit te rezervuarit te Doftise .

Ndër kulturat bujqësore që mbillen, një vënd tepër të rëndësishem zënë gruri, misri, jonxha, te cilat perdoren per nevoja vetjake por ndërkohë nuk mungojnë pemetaria dhe vreshtat.

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit është hartuar nga Bashkia Libohovë. Kjo detyrë kërkon të hartohet projekti për permiresimin e veprës ujitëse: **"Përmirësimi i skemes ujitese dhe kulluese te fushës së Bulos si dhe kanalit K-1-76 kullues ne fushe Nepravishte", Bashkia Libohovë,** për të ujitur tokat e fushes se Bulos (fusha e referuar hartes 1:25000) duke patur parasysh sa më poshtë:

- 1.- Siperfaqja që kërkohet të ujitet është 240 ha.
- 2.- Kulturat që mbillen në këto sipërfaqe janë të ndryshme si (grure, miser, jonxhe, pemtari).
- 3.- Të rehabilitohet kanalet ujitës në të gjithë gjatësinë e tij.
- 4.- Të rehabilitohet kanalet kulluese në të gjithë gjatësinë e tij.
- 5.- Të parashikohen të gjitha gërmimet për ta çuar kanalën në seksionin dhe kuotën e duhur.
- 6.- Të shihet gjëndja e kalimeve me tub çeliku nëse duhen riparuar apo zëvendësuar.
- 7.-Të parashikohen riparim vepra arti egzistuese ose të ndërtohen vepra arti të reja sipas rastit
- 8.- Rehabilitimi i kanalit të fillojë nga pjesa e lënë nga kanali i rikonstruktuar më pare deri në fund të tij.
- 9.- Vlera e objektit të përcaktohet sipas variantit të paraqitur me preventivin përkatës të hartuar për këtë qëllim duke u bazuar në analizat e çmimeve për vitin 2015.

III.- TOPOGRAFIA, GJEOLGJIA DHE HIDROLOGJIA

Sipërfaqja që kërkohet të ujitet në përgjithësi është zonë fushore me pjerrësi të vogla, tokë e zakonshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Lartësia mbi nivelin e detit e

kësaj sipërfaqe toke është rreth 250-200 m m.n.d..

Toka fushes se Bulos përgjithësisht është tokë e sistemuar mirë, gjë që krijon kushte të mira për ujitje. Tokat që kërkohen të ujitin në janë të përbëra nga depozitimet aluviale si dhe deluvialo-eluviale. Formacionet shkembore perfaqesohen nga depozitimet:

- depozitimet karbonatike te Paleocenit Pg1 te perfaqesuara nga shkembinj gelqerore shtrese trashe me pako e shtreseza gelqeroresh copezore.
- depozitimet karbonatike te Kretakut te siperm Cr1 te perfaqesuara nga nderthurje shkembinjsh gelqerore, gelqerore argjilore. gelqeroresh copezore, etj.
- depozitimet flishore te Oligocenit te siperm Pg33 te perfaqesuara nga nderthurje shkembinjsh ranore e argjilore me horizonte konglomeratesh.
- depozitimet karbonatike te Eocenit Pg2 te perfaqesuara nga nderthurje shkembinjsh gelqerore pelitomorf me gelqeroret organogjeno-copezore..

Zona ku bën pjesë sipërfaqja e tokës që do të ujitet bën pjesë në Zonën Mesdhetare Malore Jugore, me dimër të ftohtë e të lagesht dhe verë të nxehte e të thatë.

IV.- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Sipas detyrës së projektimit projekti parashikon **“Përmirësimi i skemes ujtesse dhe kulluese te fushës së Bulos si dhe kanalit K-1-76 kullues ne fushe Nepravishte”, Bashkia Libohovë.** Sipërfaqja e kërkuar që duhet të ujitet nga kanali ujitës është 240 ha, pra ky kanal duhet të llogaritet për këtë sipërfaqe.

Grupi i projektimit me lidhjen e kontratës dhe thellimin e njohurive të termave të referencës bëri rikonzicionin në vënd me përfaqësues të Bashkisë Libohove. U bënë matjet topografike të nevojshme, të kanalit egzistues dhe plotësime të mundëshme të kanalit ujitës, të dala nga sugjerimet e komunitetit prezent gjatë rikonzicionit. Pas hartimit të materialit topografik, studimit të tij, llogaritjeve të duhura hidraulike, grupi i projektimit propozon këtë variant:

Kanalet e Suhës ka si vepër marrje, kanalën e furnizimit te Ujembledhesit te Doftise qe merr uje ne lumin e Suhes ku janë bërë investime të mëparëshme bashkë ne një pjesë të rezervuarit është aktualisht në gjëndje pune. Kanalet vaditese tanë jane primar dhe sekundar te cilat fillojne në kanalën e rezervuarit te Doftise i cili eshte ekzistues dhe sherben per ujitje gjate periudhes se ujitjes.

1. Kanali V-A, V-A-1 L= 700 ml është i mbushur me material të ngurtë i cili është akumuluar ndër vite. Kanali ne pjesen me te madhe eshte me shkure dhe sipërfaqet e betonit nuk janë demtuara. Në këtë pjesë, kanali do pastrohet kanali nga materialet, dherat brenda tij, skarifikimi i sipërfaqeve te mbushura me shkure si dhe germimi i bankinave me makineri ne krahe te kanalit si edhe te resturohet tre portat kryesore te devijacionit te ujit te kanalit.
2. Kanali V-A-1 me nje gjatesi prej 1960ml rezulton i demtuar rreth 380ml nga pika e lidhjes deri ne hyrje te fshatit dhe jashte funksionit. Kanali është i mbushur me material të ngurtë i cili është akumuluar ndër vite. Kanali ne nje pjese te madhe eshte me shkure dhe bankina nuk ekziston. Në këtë pjesë, kanali do te pastrohet, do nivelohen dherat, riparohen bankinat, do ndertohet prize 40x40cm, 4(kater) cope pjesa tjetere e kanlit do te pastrohet nga dherat dhe shkuret ne gjatesine prej 1580ml deri ne kufi me bashkine Dropull .

3. Kanali V-A-2 me nje gjatesi prej 1350ml rezulton i demtuar rreth 880ml nga pika e ndarjes nga kanali kryesor deri ne gjatesine prej 880ml eshte mbushur me materiale dhe i demtuar si dhe jashte funksionit. Kanali është i mbushur me material të ngurtë i cili është akumuluar ndër vite. Kanali ne nje pjese te madhe eshte me shkure dhe bankina nuk ekziston. Në këtë pjesë, kanali do te pastrohet, do nivelohen dherat, riparohen bankinat, do ndertohet prize 40x40cm, 4(kater) cope pjesa tjeter e kanalit do te pastrohet nga dherat dhe shkuret ne gjatesine prej 1580ml deri ne kufi me bashkine Dropull .Ne kete segment do te ndertohet prize dhe ne nje pjese kanali do te zevendesohet me tub çeliku 600mm me nje gjatesi prej 32ml. Si dhe detaji e hyrjes dhe daljes
4. Kanali V-A-2-1 me nje gjatesi prej 2880ml rezulton i prishur i zhdukur i cili duhet ribere nga e para e cila furnizon parcelat ne drejtim nga Gjirokastra. Në këtë pjesë, kanali do te ribehet nga e para, do nivelohen dherat, riparohen bankinat, do ndertohet prize 40x40cm, 6(gjashte) cope pjesa tjeter e kanalit do te pastrohet nga dherat dhe shkuret ne gjatesine prej 2880ml deri ne kufi me bashkine Dropull do te ndertohet ne nje faze te dyte.
5. Kanali V-A-2-2 me nje gjatesi prej 5210 ml rezulton i prishur i zhdukur i cili duhet ribere nga e para e cila furnizon parcelat ne drejtim nga Libohova. Në këtë pjesë, kanali do te ribehet nga e para, do nivelohen dherat, riparohen bankinat, do ndertohet prize 40x40cm, 12(dymbedhete) cope pjesa tjeter e kanalit do te pastrohet nga dherat dhe shkuret ne gjatesine prej 5210ml deri ne kufi me bashkine Dropull do te ndertohet ne nje faze te dyte

Kanali V-2 rezulton shume i demtuar nga erozioni, mbushur me material te ngurte dhe me mbuluar me shkure. Në këtë pjesë, kanali do te germohet dhe mbushet per nivel tabani, do te nivelohen dherat dhe riparohen bankinat. Gjithashtu do ndertohet prize e re, barazh i ri dhe kanali ne tre pjese do te kaloj me tub çeliku 457.2/5.6mm.

Kanali V-2-1 rezulton pjeserisht i mbushur me material te ngurte. Kanali ne nje pjese te madhe eshte me shkure. Në këtë pjesë, kanali do te pastrohet, do nivelohen dherat dhe riparohen bankinat. Gjithashtu do ndertohet dy priza te reja.

Kanali V-2-3 rezulton i mbushur me material te ngurte. Kanali ne nje pjese te madhe eshte me shkure. Në këtë pjesë, kanali do te germohet do nivelohen dherat dhe riparohen bankinat. Gjithashtu do ndertohet prize e re dhe kalim me tub çeliku 457.2/5.6mm.

Përgjatë kanaleve prizat 40x40cm, barazhet 40x50cm, kalimet me tub çeliku 457.2/5.6mm dhe tombinot e betonit 600mm do të ndërtohen të reja.

V.- MBI ORGANIZIMIN E PUNIMEVE

Për ndërtimin e objektit "Përmirësimi i Fushës së Suhës", Bashkia Libohovë, në rrethin e Gjirokastrës, projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare. Do të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të zbatimit të punimeve. Gjate ndërtimit të këtij objekti të kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Gërmimet për veprat e artit janë parashikuar me krahe dhe makineri.
- 2.- Betonet janë parashikuar të prodhohen me betoniere në vend, por është e pranueshme furnizimi nga fabrikat e betonit në zonë si beton më cilësor me receta dhe raporte granulometrie materialelesh më të garantuara.
- 3.- Të gjitha betonet janë parashikuar të formohen me betonforma të reja.
- 4.- Nuk do të hidhet beton, pa përdorur vibrator sipërfaqësor.
- 5.- Materialet që do të përdoren për ndërtimin e veprës janë parashikuar të meren si më poshtë:
 - a- Inertët dhe materialet e tjera janë parashikuar të meren në afërsi të qytetit të Libohovës.
 - b- Të kihet parasysh kushtet teknike të zbatimit të punimeve për punimet me tubacione çeliku si dhe kushtet teknike për provat me ngarkesë të tubacioneve prej çeliku.
 - c- Kanalet ujitës janë egzistues që nuk kanë funksionuar gjatë 20-25 vjeteve të fundit.
 - d- Gjatë trasesë së këtyre kanaleve nuk ka infrastrukturë nëntokesore egzistuese.

TIRANE – JANAR 2019